



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. ____ prot.

Tiranë, më 5.3.2020

Lënda: Parashtrimet përfundimtare të Komisionerit Publik në seancën gjyqësore pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, datë 5.3.2020, për çështjen që i përket ankimit kundër vendimit nr. 63, datë 6.8.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit z. Arben Dollapaj

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2, e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në përfundim të këtij gjykimi, Komisioneri Publik, në mënyrë të përmbledhur, do të paraqesë qëndrimet e tij për shkaqet e ankimit, duke u qëndruar njëkohësisht të gjitha parashtrimeve që janë depozituar në seancat e zhvilluara gjatë këtij gjykimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, në lidhje me secilin shkak ankimi.

Komisioneri Publik, si institucioni që përfaqëson interesin publik në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, nënvizon si të rëndësishëm faktin se në rastin konkret, ankimi i paraqitur nga Komisioneri Publik u mbështet në fakte dhe rrethana, të cilat iu bënë me dije institucioneve të rivlerësimit nëpërmjet pjesëmarrjes së publikut në këtë proces, nëpërmjet denoncimeve dhe për të cilat ky trup gjykues pranoi të hetonte gjatë këtij gjykimi.

Komisioneri Publik konstaton se pretendimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nuk arritën të provonin të kundërtën për shkaqet e ankimit, të trajtuara në vazhdim.

Për Komisionerin Publik, shqyrtimi gjyqësor i ndërmarrë nga ana e Kolegjit mbi bazën e shkaqeve të ankimit, bazuar në nenin 179/b, pika 5, të Kushtetutës, nenin C, pika 2, nenin F, pikat 2 dhe 3 të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, provoi se:

1. Për pasurinë 1, të deklaruar nga subjekti si “Shtëpi banimi”, me vendndodhje në fshatin *, Tropojë, rezulton se:**

1.1 Lidhur me *vlerën e investimit*¹ të kësaj pasurie nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e tjerë si bashkinvestitorë, nga hetimi në Kolegj dhe provat e administruara gjatë këtij gjykimi:

i) Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e bashkinvestitorit, nuk arriti të provojë vlerën e saktë të investimit të kryer për krijimin e kësaj pasurie, si **(i.i)** për vlerën e totalit të investimit të kryer sipas Aktmarrëveshjes së investimit, datë ****.1.2013*, ashtu dhe **(i.ii)** për vlerën e investimit për pjesën takuese të tij në këtë ndërtesë.

Nga gjendja e akteve të administruara, referuar përmbajtjes së deklaratave periodike², D-Vett. dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti në këtë gjykim, rezultojnë vlera të ndryshme investimi për këtë aset³.

Gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e tij si bashkinvestitor, nuk paraqiti asnjë kontratë investimi me shoqërinë ndërtuese apo çfarëdo lloj dokumentacioni tjetër ligjor (preventiv, situacione ndërtimi, fatura tatimore për shlyerjen e detyrimeve të vlerës së ndërtimit ndaj subjektit ndërtues etj.), duke u shprehur se nuk disponon akte të tjera për të provuar: (a) vlerën e saktë të investimit; (b) kohën kur ai është kryer dhe (c) subjektin ndërtues me gjithë detyrimin ligjor që ai mbart për të provuar deklaratimet e tij, si subjekti i rivlerësimit, në referencë të nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

Pretendimi i subjektit të rivlerësimit, se nuk është në detyrimin e tij të ruajë dhe të administrojë aktet që lidhen me vlerën e investimit, subjektin ndërtues, situacionet e punimeve të kryera, vijnë në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit për zhvillimin e territorit, legjislacionit tatimor dhe legjislacionit civil, që rregullon marrëdhëniet kontraktuale, për më tepër që në rastin konkret jemi në kuadrin e detyrimit ligjor të deklaratimit të interesave private, nga një subjekt i legjislacionit përkatës.

Mungesa e provueshmërisë së vlerës së përgjithshme të shpenzuar prej subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të për ndërtimin e poseduar prej tij, e bëjnë deklaratimin e subjektit të rivlerësimit të pamjaftueshëm për të kryer çdo llogaritje objektive të ekzistencës së burimeve të ligjshme të të ardhurave të ligjshme, duke mbajtur në konsideratë po ashtu faktin se kemi të bëjmë me një pasuri, hetimi i së cilës po kryhet bazuar në denoncimet e ardhura nga publiku.

Ky qëndrim i subjektit të rivlerësimit, në referencë të mospërmbushjes së detyrimit për të provuar deklaratimet e tij gjatë procesit të rivlerësimit, merr rëndësi për t'u vlerësuar edhe bazuar në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit të Posaçëm të Apelit⁴.

ii) Subjekti i rivlerësimit, përpos se nuk arriti të provojë sa më lart, nuk provoi po ashtu edhe burimin e ligjshëm të të ardhurave të ligjshme të personave të tjerë të lidhur, z.***.*** dhe znj. ***.***, që si bashkinvestitorë kanë cilësinë e personave të tjerë të lidhur për krijimin e

¹ Përfshirë dhe përlllogaritjen e shpenzimeve për godinën në funksion të objektit si strukturë hotelerie.

² Referohuni DV-2013, DV-2014, DV-2015, DV-2016 dhe D-Vett.

³ Deklaruar respektivisht në D-Vett., vlera 5.000.000 lekë, sipas preventivit të vitit 2010, dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI, vlera totale e investimit llogaritet në shumën 5.882.794 lekë, referuar preventivit të vitit 2019, pjesa e investuar nga subjekti i rivlerësimit është në shumën 4.219.140 lekë.

⁴ Referohuni paragrafit 31, 35 të vendimit nr.19/2019 (JR), të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

kësaj pasurie, secili me 1/3 pjesë, sikundër është argumentuar edhe në parashtrimet para këtij trupi gjykues në seancën gjyqësore të datës 16.12.2019⁵ dhe në datën 4.2.2020⁶.

1.2 **Lidhur me gjendjen faktike** të kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit gjendet: **i)** në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm, lidhur me funksionin e pasurisë, pasi rezultoi e provuar se kjo pasuri, përpara se subjekti i rivlerësimit të dorëzonte D-Vett., është regjistruar pranë QKB-së në datën ***.7.2016, si sipërmarrje private me objekt aktiviteti “*Bujtinë, shtëpi pritjeje (Guest - House)/strukturë hotelerie*”, fakt i pranuar edhe nga vetë subjekti në parashtrimet e tij të datës 4.12.2019, **ii)** deklaramit të pamjaftueshëm edhe për sa i përket numrit të kateve, pasi nga vetë provat e depozituara nga subjekti gjatë gjykimit në Kolegj,⁷ rezulton se objekti faktikisht ngrihet në disa kate ndërtimi.

Sot, në përfundim të këtij gjykimi, subjekti i rivlerësimit mbetet kontradiktor në lidhje me gjendjen faktike të godinës. Ndërkohë që vetë subjekti i rivlerësimit pretendon se godina ende nuk është e përfunduar, një deklaratë noteriale e paraqitur po prej tij, në cilësinë e provës, e hartuar nga tre bashkëposeduesit e tjerë (deklaratë e nëntorit 2019)⁸ në përmbajtjen e saj i referohet godinës si një objekt i përfunduar dhe i gatshëm për t’u ndarë në pjesë në natyrë.

Qoftë në deklaramit e subjektit të rivlerësimit, në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ, por dhe në një akt vlerësimi të hartuar nga një profesionist i fushës, paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit në këtë gjykim, nuk rezulton të saktësohet, sikur edhe vetëm në mënyrë deklarative, sesa është sipërfaqja totale në këtë ndërtim që posedohet nga subjekti i rivlerësimit apo numri i kateve që ai posedon në ndërtesë.

1.3 Lidhur me verifikimin e “Lejes së zhvillimit” për pasurinë dhe mënyrën e zbatimit të saj nuk provohet se “Leja zhvillimore” e datës ***.3.2013 dhe “Leja e ndërtimit” e datës ***.3.2013, janë dhënë në përputhje me dispozitat e ligjit nr.10119/2010⁹, edhe për sa i përket zhvillimit të ndërtimeve në zonat e mbrojtura “Park Kombëtar”¹⁰, si elemente të vlerësimit të ligjshmërisë së ndërtimit, të kryer nga subjekti i rivlerësimit që prej vitit 2013, në cilësinë e bashkinvestitorit.

1.4 Në këto kushte, për këtë pasuri rezulton se subjekti ka kryer deklaramit të pasaktë, të paplotë, ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme, duke kryer në këto rrethana deklaramit të pamjaftueshëm, në kuptim të pikës 1, 3 dhe 5 të nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

2. Për pasurinë 2, “Ndërtesë 3-katëshe në rrugën ‘*.***’”, Tiranë**, në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit me të vëllain, z. ***.***, në përfundim të gjykimit, në gjendjen që janë aktet e administruara deri në përfundim të këtij gjykimi, Komisioneri Publik vlerëson të shprehet për këto elemente të ndërlidhura me njëri-tjetrin:

⁵ Pika 1.3.4 e parashtrimeve të Komisionerit Publik.

⁶ Pika 1.3.5 e parashtrimeve të Komisionerit Publik.

⁷ Raport i ing. ***.***, depozituar nga subjekti i rivlerësimit në seancën e datës 4.12.2019; videoregjistrimet të ndërtimit, depozituar nga subjekti i rivlerësimit në seancën e datës 16.1.2020.

⁸ Deklaramit noteriale nr. *** rep., nr.*** kol., datë ***.11.2019.

⁹ Ligji në fuqi në momentin e lëshimit të lejeve.

¹⁰ Vendimi nr.102, datë 15.1.1996, i Këshillit të Ministrave, e ka shpallur Luginën e Valbonës “Park Kombëtar”.

- i. Plotësimi i kriterëve për përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese nga subjekti i rivlerësimit, sipas VKM-së nr. 600/2007;
- ii. Evidentimi i kohës së përfundimit të katit shtesë 113 m², deklaruar në DV-2007, vlera dhe gjendja e tij deri në vitin 2011.

2.1 Lidhur me *pasurinë 2*, subjekti i rivlerësimit gjendet:

i) Në kushtet e deklarimit të pasaktë në D-Vett., ku nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie për vlerën 9.000.000 lekë.

ii) Në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për *huan në shumën 25.000 USD*, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si një nga burimet për krijimin e pasurisë. Komisioneri Publik, ashtu si edhe në parashtrimet e datës 16.12.2019¹¹ dhe të datës 4.4.2020,¹² ka vlerësuar se provat dhe aktet e paraqitura mbi këtë shkak nuk konsiderohen si dokumentacion justifikues ligjor mbi burimin e ligjshëm të huas së dhënë nga kunati tij, z. ***.***.

iii) Në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të ligjshme për krijimin e shtesës së katit me sipërfaqe 113 m², në vlerën 1.700.000 lekë,¹³ duke rezultuar me pamjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme në shumën - 810.767 lekë.

Referuar provës shkresore (*mandat pagese bankare, Banka ****, datë ****.3.2011*, kryer nga z. *Arben Dollapaj*), administruar gjatë hetimit administrativ në lidhje me shlyerjen e detyrimit (taksë vendore) për ndikimin në infrastrukturë të ndërtimit që legalizohet, rezulton se vlera e investimit për katin shtesë është 3.638.807 lekë, vlerë kjo që e rrit diferencën negative të konstatuar me një shumë prej -1.938.807 lekë, në referencë të të ardhurave të ligjshme, që kanë shërbyer për ndërtimin nga ana e subjektit të rivlerësimit të shtesës së katit.

Në këtë gjendje të provave, referuar momentit kohor të lartpërmendur, kur objekti shtesë kati ka qenë i përfunduar, rezulton se subjekti i rivlerësimit është trajtuar me kredi të butë për strehim, në një kohë (datë 18.5.2011) kur posedonte sipërfaqe banimi për të dhe familjen e tij. Sa më lart duhet të vlerësohet duke iu referuar jurisprudencës së këtij Kolegji, për rastet e përfitimit të kredisë së butë, për strehim nga subjektet e rivlerësimit, në kushtet e mosplotësimit të kriterëve ligjore dhe ndikimit të këtij elementi në vlerësimin e etikës dhe vlerësimin tërësor të subjektit të rivlerësimit.

2.2 Në përfundim edhe për *pasurinë 2*, rezulton se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme, ka kryer deklaram të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, dhe ka cenuar etikën e magjistratit në përfitimin e kredisë së butë për strehim, në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në legjislacionin përkatës.

3. Për dhuratat e të afërmeve, në shumën totale 10.900 USD e 200 euro, dhe diferencat negative ndër vite

¹¹ Pika 2.4 e parashtrimeve të Komisionerit Publik.

¹² Pika 1.4.2 e parashtrimeve të Komisionerit Publik.

¹³ Referuar vlerës së deklaruar të investimit DV-2007.

Nga analiza e provave të depozituara dhe e prapësimeve të subjektit të rivlerësimit gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, u arrit të provohet vetëm burimi i ligjshëm për shumën e dhuruar nga mbesa e subjektit, znj. ***.***, në vlerën 2000 USD.

3.1 Ndërkohë për të ardhurat nga dhurimet e tjera, referuar dokumentacionit justifikues të paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit në Kolegj, nuk provohet se dhuruesit (znj. ***.***, znj. ***.*** dhe znj. ***.***) kishin të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme për t'i dhuruar shumat e deklaruara subjektit të rivlerësimit, siç është arsyetuar dhe në parashtrimet në seancën e datës 16.12.2019¹⁴.

Lidhur me të ardhurat nga dhuratat rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka paguar detyrimet tatimore në zbatim të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 5, datë 30.1.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat" (të ndryshuar). Si rrjedhim, mospërfshirja e dhurimeve si të ardhura të ligjshme në analizën financiare na çon në konkluzionin se subjekti nuk mbulon me burime të ligjshme pagesat, shpenzimet dhe investimet e kryera edhe për vitet 2006, 2008 dhe 2013.

3.2 Për sa më sipër, konstatojmë se, edhe pas hetimit të shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik nga ky trup gjykues, prapësimeve të depozituara, qëndrimet e subjektit të rivlerësimit, në kuptim të detyrimit për të provuar të kundërtën, mbeten më së shumti në nivel deklarativ dhe nuk u arrit të provohet bindshëm burimi i ligjshëm i të ardhurave të ligjshme, që kanë shërbyer për krijimin e pasurive të deklaruara, përkundër shkaqeve të ankimit, në lidhje me diferencat negative të konstatuara ndër vite.

I. Kërkimi përfundimtar i ankimit

4. Në përfundim të këtyre parashtrimeve, Komisioneri Publik vlerëson se:

4.1 Në interpretim të pikës 1, 3 dhe 5, të nenit D të aneksit të Kushtetutës, shkronjës "b", të nenit 33, pikës 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë të burimeve financiare, nuk arrin të justifikojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive të deklaruara prej tij dhe të personave të lidhur me të, duke kryer kështu deklaram të pamjaftueshëm dhe cenuar besimin e publikut në vlerësimin tërësor të procedurave;

4.2 Komisioneri Publik, bazuar në dispozitën e pikës 3 dhe 7 të nenit F, të aneksit të Kushtetutës, shkronjës "b", të pikës 3 dhe 5 të nenit 61, të pikës 1 të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, kërkohet nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 63, datë 6.8.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Dollapaj, magjistrat/prokuror, aktualisht anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA

¹⁴ Pika 4 e parashtrimeve të Komisionerit Publik.